



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 26.6.2023

Nr: 676

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 380 ID, 381 ID, 383 ID, 411 ID, 422 ID, 423 ID, 396 ID, 428 ID, 425 ID TË DEPUTETIT Z. IVI KASO DHE ZJ. ALBANA VOKSHI, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 26 Qershor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Z. Ivi Kaso, Sekretar për Çështjet Zgjedhore
Zj. Albana Vokshi, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

SUBJEKT: Zj. Emiriana Sako, kryetar i bashkisë Durrës;
Zj. Irena Toshkallari, drejtori i Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Vlorë- Himarë;
Z. Ermal Dredha, kandidat për kryetar të bashkisë Vlorë;
Zj. Bukuri Ballhysa, drejtor i shkollës 9- vjeçare “28 Nëntori” Pekisht;
Z. Leonard Greku, drejtori i shkollës “18 Tetori” Lushnje;
Z. Rahim Spahiu, kryetar i bashkisë Dibër;
Z. Adriatik Mema, kryetar i bashkisë Skrapar;
Z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan;
Zj. Evis Kushi, Ministër i Arsimit dhe Sportit;
Z. Ermir Çela, drejtori i Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Elbasan;
Z. Agron Malaj, kryetar i bashkisë Mat.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Nga sekretari për çështje ligjore z. Ivi Kaso dhe nga deputeti i Kuvendit të Shqipërisë zj. Albana Vokshi, janë marrë indicie për organizimin e 9 (nëntë) veprimtarive publike, nga 9 (nëntë) institucione publike, për të cilat pretendohet se janë kryer shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve/denoncimeve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- Denoncimi **380 ID**, më kërkuar z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 159 prot., datë 29.4.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4561 prot., datë 3.5.2023 dhe zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 13039, i datës 2.5.2023 ku pretendohet se: *“ Disa javë para zgjedhjeve vendore të 14 majit, kandidatja e Partisë Socialiste për bashkinë Durrës përdor studentë e nxënës të shkollave 9-vjeçare në fushatë elektorale. Kështu, dt 1 maj ka zhvilluar një aktivitet që e ka postuar edhe ne rrjetet sociale të saj ku shkruan:*

#MjedisIPastër

#QytetarëTëShëndetshëm

Bashkë me vullnetarë të lëvizjes “River Cleanup Albania”, studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës, nxënës të shkollave 9-vjeçare të Durrësit, vijuan me mbjelljen e pemëve pranë stadiumit “Niko Dovana”, si dhe shprehëm mbështetjen tonë për kauzën aq shumë të dobishme të diferencimit të mbetjeve që në burim.

Të gjithë së bashku do të bëjmë të mundur realizimin e projektit për diferencimin e mbetjeve të riciklueshme, nëpërmjet grumbullimit dhe më pas transferimit të i tyre.

Pika për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme, planifikohet të ndërtohet në të njëjtin vend ku do jetë edhe stacioni i transferimit, me qëllim uljen e kostos së transportit.

Ky projekt ambicioz në mbrojtje të mjedisit , do të realizohet mandatin e ardhshëm, ku pjesë e rëndësishme do të jenë të rinjtë, që janë shembulli më i mirë i edukimit dhe realizimit të ketyre iniciativave në dobi të qytetit dhe qytetarëve tanë.

#VotoNr2 #

EmirianaSako

#Vetëmpërpara

#KrenarePërPs”

Më datë 4.5.2023 bashkisë Durrës, i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë dhe me datë 24.5.2023 jemi informuar se: *“Në lidhje me denoncimin nr. 380 ID, ju bëjmë me dije se Bashkia Durrës nuk ka qenë në cilësinë e organizatorit të veprimtarisë publike, objekt denoncimi. Bashkia Durrës ka qenë në cilësinë e të ftuarit në këtë aktivitet nga Organizatori “Lëvizja vullnetare-qytetare-edukuese-mjedisore-humanitare River Cleanup Albania. Sqarojmë se ky aktivitet është zhvilluar, me rastin e Ditës së Tokës, tek Stadiumi “Niko Dovana” i qytetit të Durrësit, ku kanë marrë pjesë 11 shkolla të qytetit të Durrësit, si dhe dhe studentët e UAMD-së”.*

Më datë 4.5.2023, i është kërkuar informacion Zyrës Arsimore Parauniversitare Durrës për rastin mësipërm, por nuk kemi marrë një informacion sqarues.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin me **nr. 380 ID**, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë u paraqit përfaqësuesi i bashkisë Durrës, i cili sqaroi se aktiviteti është zhvilluar brenda kornizave ligjore. Aktiviteti është zhvilluar ditë të shtunë, me rastin e "Ditës së Tokës" dhe pjesëmarrja e zj. Sako ka qenë brenda këtyre kornizave ligjore.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Referuar pikës 1, të nenin 92, të Kodit Zgjedhor *"Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre"* detyrimi për raportim i atribuohet vetëm institucioneve publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore.

Referuar të dhënave dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, u vlerësua se aktiviteti i mësipërm është organizuar nga organizata "River Cleanup Albania", e cila nuk ka detyrimin për të raportuar në ndërfaqe.

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor *"Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia"*. Më tej, pika 2 e këtij neni parashikon se *"burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet **përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit Brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.***

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Po ashtu referuar vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në kuptim të këtij akti “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë ndër të tjera **përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim**”.

Për sa këto dispozita parashikojnë, shihet qartë se në mënyrë që të ndodhemi para shklejes duhet të provohet plotësimi i kushteve kumulative mbi përdorimin e **detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar**.

Nga verifikimi i provave dhe fakteve të administruara gjatë shqyrtimit administrativ, vlerësohet se provat e disponuara nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme për vërtetimin e shkeljes së pretenduar nga denoncuesi. Në çështjet objekt shqyrtimi nuk u arrit të provohej përdorimi i detyruar i nxënësve brenda orarit mësimor. Po ashtu theksohet se nga shqyrtimi i materialeve foto vërehet qartazi se këto aktivitete nuk janë zhvilluar në ambientet e shkollave, por vërehet se janë zhvilluar në ambiente private.

Gjithashtu nga shqyrtimi i materialeve nuk arrihet të provohet se në këto aktivitete janë bërë premtime apo është bërë ofrimi i përfitimeve nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se për rastin objekt denoncimi regjistruar me nr. 380 ID, për bashkinë Durrës dhe Zyrën Vendore Arsimore Durrës, nuk u konstatua shkelje e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit. Për rrjedhojë vlerësohet se duhet të pushohet hetimi administrativ për palën e denoncuar.

- **Denoncimi nr. 381 ID**, më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 158 prot., datë 29.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4560 prot., datë 3.5.2023 dhe zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 12980, i datës 1.5.2023 ku pretendohet se:

"Arsimtarë, drejtues të arsimit në Vlorë, nën drejtimin e kreut të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë zhvilluan një takim elektoral me kandidatin për kreun e Bashkisë, Ermal Dredha dhe të tjerë eksponent të Ps-së. Kjo është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe disa VKM. Ndërsa duhet të ishin duke ju dhënë dije brezave të rinj, ata janë bërë pjesë e fushatave politike eletorale. Ndërkohë që për çdo aktivitet publik duhet njoftuar KQZ 5 ditë para,

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

arsimtarët në 'ditën me diall' mblidhen dhe bëjnë fushatë. Si ata arsimtare që kanë qenë të pranishëm në aktivitet dhe ata që nuk kanë qenë kanë bërë 'like' dhe 'share', si për të thënë 'shënomëni dhe mua', pasi presioni për të ruajtur vendin e punës është shumë i lartë."

Më datë 13.5.2023 Zyrës Arsimore Parauniversitare Vlorë-Himarë i është kërkuar informacion në lidhje me objektin e denoncimit.

Më datë 16.3.2023 Zyra Arsimore Parauniversitare Vlorë-Himarë ka sqaruar se "Në vijim të denoncimit të paraqitur kundër Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 4560 prot. datë 03.05.2023, bëjmë me dije: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë në zhvillimin e veprimtarisë së saj ka respektuar parashikimet e ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Aktiviteti i denoncuar nuk është organizuar nga institucioni ynë. Ky aktivitet është organizuar dhe zhvilluar nga një subjekt politik dhe në kohë që nuk përkon me orarin zyrtar të punës. Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kreun IV neni 6 pika pikën 3, dhe 4 ka parashikuar ndalimet dhe të drejtat që kanë punonjësit e administratës shtetërore (ku përfshihen dhe mësuesit si punonjës me Kod Pune):

3.Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.

4.Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.

Në rastin konkret nuk jemi para ndalimeve të parashikuara në pikën 3 të VKM-se pasi aktiviteti është zhvilluar në pasdite, jashtë orarit zyrtar të punës.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar nuk përgjigjet për pjesëmarrjen në veprimtari politike të punonjësve të saj pas orarit zyrtar të punës, pasi me përfundimin e këtij orari, çdo punonjës, në përputhje me pikën 4, neni 6 të VKM-së ka të drejtë ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.

Institucioni ynë jo vetëm nuk ka organizuar në asnjë rast aktivitete me subjekte zgjedhore, por ka përmbushur me përpikmëri detyrimin e tij ligjor për të njoftuar të gjithë punonjësit mbi ndalimet që Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve parashikon.

Me shkresën nr.194 prot, datë 23.01.2023, shkresën nr. 503 prot, datë 28.03.2023, shkresën nr. 504 prot, datë 28.03.2023 janë njoftuar dhe janë rikujtuar të gjithë punonjësit nën juridiksionin e ZVAP-it Vlorë-Himarë mbi detyrimet dhe ndalimet që legjislacioni në fuqi iu ngarkon, për aktivitetet politike.

Në dispozicion të punonjësve është vendosur në rrugë elektronike Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Lidhur me postimet në rrjetet sociale, theksojmë se: nuk janë postime në faqen zyrtare të institucionit, por postime në profile personale dhe për më tepër jashtë orarit të punës, për rrjedhojë nuk përbëjnë shkelje administrative. Pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë për sa kohë nuk ka asnjë aktivitet të organizuar nga ZVAP-i Vlorë-Himarë apo pjesëmarrje të punonjësve në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar të punës. Nuk është zhvilluar anjë veprimtari publike e organizuar nga institucioni ynë, për rrjedhojë nuk ka vend për raportim pranë KQZ-së. Për sa më sipër, kërkojmë mospranimin e ankesës si të pabazuar në ligj dhe prova.”

Në përfundim administrativ vlerësoj se, referuar nenit 91, pika 2 të Kodit Zgjedhor “Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Kjo dispozitë kërkon “**përdorimin e detyruar brenda orarit të punës**” dhe “**për qëllime zgjedhore**”. Në mënyrë që të provohet shkelja administrative, nga ana e punonjësve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet, duhet të vërtetohet në mënyrë komulative fakti pjesëmarrja e punonjësve në këtë aktivitet ka qenë e detyruar, brenda orarit të punës dhe ka pasur qëllim zgjedhor. Fakti që ndodhemi para një aktiviteti elektorale, nuk vërteon faktin se pjesëmarrja ka qenë e detyrueshme. Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në nenin 6, pika 3 e qartëson edhe me tej nenin 91, pikën 2 të Kodit Zgjedhor. Neni parashikon se “*Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje.*

Referuar fakteve të denoncuar dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk u arrit të provohej se pjesëmarrja e punonjësve ka qenë e detyruar dhe as që është ushtruar presion ndaj tyre me qëllim përfitimi. Të ndodhur në këto kushte, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin me nr. 381 ID, pasi të dhënat e denoncuar dhe provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe përdorimi i burimeve publike në favor të një kandidati apo subjekti zgjedhor.

- Denoncimi **383 ID, më kërkues z. Ivi Kaso**, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 154 prot., datë 22.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4557 prot., datë 3.5.2023 **dhe zj. Albana Vokshi**, deputet i Kuvendit të Shqipërisë,

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 12408, i datës 27.4.2023 ku pretendohet se: *“Në fshatin Pekisht, Elbasan, janë thirrur prindërit e nxënësve të kësaj shkolle dhe ju është kërkuar, të japin informacion nga shkolla nëse marrin ndihmë ekonomike apo janë në punë, me qëllim përdorimin e tyre nga partia në pushtet dhe përfitimin e votave, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore si më lart”*. Sipas denoncuesit, shkelja e mësipërme është shkelje flagrante e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Më datë 4.5.2023, Zyrës Arsimore Parauniversitare Elbasan i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë dhe më datë 15.5.2023 jemi informuar se *“Lidhur me denoncimin e ardhur nga Partia Demokratike për shkollën në fshatin Pekisht dhe drejtorin e këtij institucioni, ju informojmë se kjo shkollë nuk është shkollë nën juridiksionin e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Elbasan dhe në këto kushte nuk kemi informacion lidhur me ngjarjen apo drejtuesin e kësaj shkolle”*.

Pas verifikimeve, më datë 23.5.2023, Zyrës Arsimore Parauniversitare Peqin, i është kërkuar informacion përse pretendohet nga denoncuesi dhe në datë 25.5.2023, jemi informuar se: *“Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Peqin ju informon, se nje gjë e tillë, nuk është e vërtetë dhe e përgënjeshtrojmë rastin e mësipërm si të pavërtetë, pasi në asnjë rast nuk është kërkuar nga drejtoria e shkollës 9- Vjeçare "28 Nëntori" Pekisht të ketë thirrur prindërit e nxënësve të kësaj shkolle, të japin informacion nëse marrin ndihmë ekonomike apo që janë në punë. Gjithashtu një gjë e tillë përgënjeshtrohet edhe nga drejtoresha e shkollës 9- Vjeçare "28 Nëntori" Pekisht zj. Bukuri Ballhysa, me deklaratën e datës 24.05.2023, me nr. 69 prot. Përse më lart Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Peqin, dëshiron t'iu nënvizojë se, në ushtrimin e detyrës së tij ka qenë plotësisht i ndërgjegjshëm dhe i angazhuar për të zbatuar në mënyrë korrekte dhe transparente të gjitha detyrimet e tij ligjore. Bashkëlidhur, shkresa e drejtoreshës së shkollës 9- Vjeçare "28 Nëntori" Pekisht”. Në deklaratën e datës 24.5.2023, me nr. 69 prot., zj. Bukuri Ballhysa, drejtor i shkollës 9- vjeçare “28 Nëntori” Pekisht, ka deklaruar se *“Nuk kam kërkuar, nuk kërkoj dhe nuk do të kërkoj një informacion të tillë pasi nuk përfshihet në kompetenct e mia si drejtor e këtij institucioni arsimor. Përse i përket rastit në fjalë jam e gatshme të ballafaqohem përpara organeve kompetente për zbardhjen e kësaj ngjarje”*.*

Në përfundim të hetimit administrativ vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor parashikohet se, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor**, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”. Më tej, pika 2, e këtij neni parashikon se “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet **përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës** së institucionit brenda orarit të punës **për qëllime zgjedhore**, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu **premtimi ose ofrimi i përfitimeve** nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim

Në mënyrë që të konstatohet shkelja e nenit 91, pika 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor, duhet të vërtetohet fakti që përdorimi i burimeve njerëzore të jetë bërë **për qëllime zgjedhore**, dhe brenda orarit të punës. Referuar fakteve të denoncuara dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk u arrit të provohej se mesazhet e dërguara në aplikacionin "whatsapp" janë iniciuar nga drejtori i shkollës 9- vjeçare "28 Nëntori" Pekisht dhe as qëllimi zgjedhor në dërgimin e këtyre mesazheve. Të ndodhur në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj zj. Bukuri Ballhysa, drejtor i shkollës 9-vjeçare "28 Nëntori" Pekisht, pasi të dhënat e denoncuara dhe provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe përdorimin e burimeve publike në favor të një kandidati apo subjekti zgjedhor.

- Denoncimi **nr. 411 ID**, më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 182 prot., datë 8.5.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4867 prot., datë 9.5.2023 dhe zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 13468, i datës 8.5.2023 ku pretendohet se: *"Në kundërshtim të hapur me legjislacionin në fuqi, të cilat parashikojnë në një mënyrë solide ndalimin e shpërdorimit të burimeve administrative, shtetërore, publike dhe për minimizimin e avantazheve që vijnë nga të qenit në pushtet, institucionet arsimore po përfshihen hapur në fushatën zgjedhore në mbështetje të kandidatëve të PS. Rasti me i fundit flagrant është ai i Gjimnazit '18 Tetori' Lushnje që në një sondazh online të organizuar para disa ditësh nga Radio Lushnja, ka marrë pjesë në të duke i dhënë mbështetje publike përmes faqes zyrtare, kryetares aktuale të Bashkisë Lushnje njëherazi candidate e Partisë Socialiste për këtë bashki, Eriselda Sefa".*

Më datë 11.5.2023, Zyrës Arsimore Parauniversitare Lushnje i është kërkuar informacion në lidhje me objektin e denoncimit. Më datë 13.5.2023, drejtori i shkollës "18 Tetori" z. Leonard Greku ka sqaruar se *"Ju bëjmë me dije se faqja e facebook-ut të gjimnazit " 18 Tetori" është menaxhuar prej disa vitesh nga drejtori i shkollës dhe nga nëndrejtori i shkollës. Në cilësinë e drejtorit të gjimnazit 18 Tetori" Lushnje ju informoj dhe ju garantoj se unë personalisht nuk kam marrë pjesë në asnjë sondazh të natyrës politike të zhvilluar nga Radio Lushnja dhe në asnjë sondazh tjetër, as përmes faqes së facebook-ut të shkolles as nga faqja ime personale. Duke qenë se faqja e facebook-ut të shkollës ka qenë në administrim edhe nga znj. Manjola Prifti, ish nëndrejtoreshë e shkollës, e cila ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga pozicioni i nëndrejtorit më datë 15 Mars 2023 dhe aktualisht gjendet jashtë shtetit, e kontaktova zj.*

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Manjola Prifti dhe i kërkuva informacion për sa më sipër. Zj. Manjola Prifti më konfirmoi se ka klikuar padashje si administratore nga faqja e shkollës në sondazhin e bërë nga Radio Lushnja duke menduar se ka qenë në faqen e saj personale, kjo pasi faqja e shkollës dhe faqja e saj personale ndërveprojnë. Zonja Manjola Prifti, ish nëndrejtoreshë e shkollës, e cila nuk është më pjesë e sistemit arsimor prej datës 15 Mars 2023, me kërkoi ndjesë për gjithë problematikën e krijuar pa vullnetin e saj. Në cilësinë e drejtorit të gjimnazit "18 Tetori" Lushnje konfirmoj gjithashtu se ditën e sotme ndryshova menjëherë fjalëkalimin e faqes së facebook-ut të shkollës dhe se nga sot jam i vetmi person që e administroj këtë faqe duke shmangur në këtë mënyrë çdo ndërveprim të faqes së facebook pa dijeni time nga persona të tjerë. Cilësoj gjithashtu se në faqen zyrtare të gjimnazit "18 Tetori" të gjitha postimet e bëra në vite janë konform legjislacionit në fuqi. Bashkëlidhur gjeni deklaratën e dorëheqjes bërë më datë 15.03.2023 nga znj. Manjola Prifti".

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor "Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje** burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia". Më tej, pika 2 e këtij neni parashikon se "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.

Faqet zyrtare të institucioneve publike konsiderohen si burime publike, të cilat nuk mund të vendosen në dispozicion të kandidatëve apo subjekteve zgjedhore. Publikimi apo ripostimi i materialeve të cilat kanë përmbajtje elektorale në faqet zyrtare të institucioneve publike, vlerësohet nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si përdorim i burimeve publike.

Megjithatë, referuar rastit konkret nuk kemi të bëjmë me një postim në faqen zyrtare të gjimnazit "18 Tetori" Lushnje, por me një votim në një sondazh, në mbështetje të një subjekti zgjedhor të caktuar. Menaxhimi i faqes së shkollës është bërë nga një person i cili në momentin e kryerjes së votimit në sondazh, nuk ka qenë në ushtrim të detyrës së vet. Për shkak të një gabimi në menaxhimin e faqeve, ish- nëndrejtoresha e shkollës "18 Tetori" ka marrë pjesë në këtë sondazh. Në këto kushte vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

- **Denoncimi nr. 422 ID** më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 192 prot., datë 11.5.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 5059 prot., datë 12.5.2023 ku pretendohet se "Mbështetur në videon e dërguar nga qytetarët në bashkinë Dibër, ku duket shtrimi i asfaltit elektoral pas propagandës së zj. Balluku dhe kandidatit për kryetar bashkie Dibër z. Rahim Spahiu, në mënyrë selektive me

qëllim përfitimin e votave në favor të kësaj force politike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendoret të datës 14 Maj 2023".

Më datë 13.5.2023, bashkisë Dibër i është kërkuar informacion në lidhje me objektin e këtij denoncimi dhe më datë 14.5.2023, jemi informuar se "Lidhur me denoncimin ndaj bashkisë Dibër me nr. 5059 prot., datë 12.05.2023, ku pretendohet për shtrim të asfaltit elektoral për propogandë politike ju informojmë se: Investim për të cilin është bërë denoncimi është parashikuar në buxhetin e vitit 2022. Në Sistemin e Prokurimeve Publike (SPE) është hapur procedura me numer reference Ref-51597-11-25-2022 dhe objekt "Rikonstruksion dhe sistemin asfaltimi i rruges së ish-ndermarrjes se Grumbullimit", Lagjia "Gjok Doçi". Në zbatim të dispozitave ligjore është bërë e mundur lidhja e kontratës me nr. prot. 398 datë 27.01.2023. Pas kësaj është vazhduar me fillimin e punimeve".

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me nr. 422 ID, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor parashikohet se, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor**, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia".

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator ka dalë në zbatim të nenit 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**. Vendimi nuk ka për qëllim të ndalojë funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe as të ndalojë procedura normale administrative që kryejnë këto institucione.

Referuar nenit 3, pika 1.3, shkronja "c" e këtij vendimi parashikon se vënia **në dispozicion e asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme** të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, **për qëllime zgjedhore**, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, përbën përdorim të burimeve publike. Në mënyrë që të konstatohet shkelja e dispozitave të vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, përveçse kërkesave që parashikon neni 3, pika 1.3, shkronja "c", duhet njëkohësisht të vërtetohet qëllimi zgjedhor që ka pasur institucioni në nxjerrjen e një akti të tillë, si kërkesë e pikës 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Vetëm fakti që një akt nxirret gjatë periudhës zgjedhore apo shtrohen rrugë gjatë periudhës zgjedhore, nuk vërteton "qëllimin zgjedhor", si kërkesë absolutisht të domosdoshme

për vërtetimin e shkeljes.

Kështu, në mënyrë që të konstatohet shkelja e këtij nenit duhet të provohohen në mënyrë komulative të gjitha elementët e mëposhtëm :

- 1- Fondet për shtrimin e rrugëve duhet të jenë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.
- 2- Përdorimin ose të vënien në dispozicion të burimeve publike të një organi publik, me qëllim mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

Gjatë hetimit administrimit nuk u arrit të vërtetohej qëllimi zgjedhor në miratimin e një vendimi, i cili rezultoi të jetë bërë në respektim të procedurave të vendosura nga kontratat e lidhura midis institucioneve dhe kontraktorëve. Përsa më sipër, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin nr. 422 ID pasi në këtë rast institucioni publik ka kryer detyrat e tij funksionale dhe nuk jemi para një veprimtarie të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

- **Denoncimi nr. 423 ID** më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore të Partisë Demokratike, nëpërmjet shkresës nr. 193 prot., datë 11.5.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 5058 prot., datë 12.5.2023, ku pretendohet se: *“Mbështetur në denoncimin e kryer nga Sekretarja e Marrëdhënieve me publikun në Partinë e Lirisë zj. Silvi Caka, e cila ka regjistruar imazhet në godinën e bashkisë Skrapar, e cila në orarin zyrtar të punës (ora 15:00) është e boshatisur dhe e mbyllur duke mos mundësuar dhënien e shërbimit kundrejt qytetarëve pasi punëmarrësit ishin zhvendosur të gjithë pranë sheshit ku u mbajt takimi elektorale me kryeministrin z. Rama”.*

Më datë 13.5.2023, i është kërkuar informacion bashkisë Skrapar në lidhje me objektin e denoncimit dhe më datë 16.5.2023, jemi informuar se *“Bashkia Skrapar, pasi u njoh me denoncimin e Sekretares së Marrëdhënieve me Publikun të Partisë së Lirisë ju informojmë se referuar ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, V.K.M nr. 568 datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë, për të ulur konsumin e energjisë elektrike në institucione është nxjerrë urdhëri me nr. 187/1 datë 4.1.2023 i protokolluar me nr. 1795/1 prot, datë 4.1.2023 ku është vendosur se “1. Orari zyrtar i punës në Bashkinë Skrapar dhe Institucionet në varësi të saj, të fillojë në orën 08:00 dhe të përfundojë në orën 15:00, deri në një urdhër të dytë”.*

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor parashikohet se, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor**, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”. Më tej, pika 2, e këtij neni parashikon se “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet **përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës** së institucionit brenda orarit të punës **për qëllime zgjedhore**, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu **premtimi ose ofrimi i përfitimeve** nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimor, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Denoncuesi pretendon se punonjësit e bashkisë Skrapar, gjatë orarit të punës, kanë marrë pjesë në një aktivitet elektorale të subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Në materialin video, të dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk tregohen mjaftueshëm të dhëna, si data dhe ora kur është regjistruar video. Gjithashtu, denoncuesi nuk ka arritur të provojë se mungesa e punonjësve lidhet drejtpërdrejt me pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin elektorale. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se hetimi administrativ ndaj bashkisë Skrapar duhet të pushohet për shkak se nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

- **Denoncimi nr. 396 ID** më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore të Partisë Demokratike, nëpërmjet shkresës nr. 177 prot., datë 04.5.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4686 prot., datë 5.5.2023 ku pretendohet se: *“Në Gjirokastrë, ka nisur shtrimi i rrugëve me beton 10 (dhjetë) ditë përpara zgjedhjeve”*.

Bashkëngjitur denoncimit janë dërguar provat fotografike të rrugës ku është hedhur asfalti për të cilin pretendon denoncuesi.

Më datë 7.5.2023, i është kërkuar informacion bashkisë Gjirokastrë dhe më datë 17.5.2023 jemi informuar se *“Bashkia Gjirokastrë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, VKB-së nr. 107 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022” ka miratuar “Urdhërin e Prokurimit” nr. 408, datë 03.06.2022 për realizimin e prokurimit “Procedurë Prokurimi e Hapur- Mall”, me objekt “Materiale ndërtimi për mirëmbajtje të segmenteve të ndryshme rrugore”, me fond limitit 11.666.657 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e*

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

pesëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH. Në bazë të llojit të procedurës përcaktohet dhe afati kohor për zhvillimi e saj ku në këtë rast është 30 ditor. Me nr. REF 35516-07-06-2022 është publikuar më datën 07.07.2022 procedura e prokurimit nr. 1, e objektit të sipërcituar. Më datën 27.07.2022, është bërë hapja dhe vlerësimi i ofertave. Më datën 26.08.2022, është bërë mbyllja e vlerësimit ku rezulton se janë skualifikuar të gjashtë operatorët pjesëmarrës për shkak të mosplotësisimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të dokumentave standarde të tenderit. Pas publikimit të vendimit të Autoritetit Kontraktor për skualifikimin e të gjithë operatorëve është bërë ankesë nga një OE dhe ku prej kësaj ka dalë në vendim Komisioni I Prokurimit Publik për anulimin e procedurës. Me anë të nr. REF 44174-10-03-2022 është publikuar më datën 04.10.2022 procedura e sipërcituar për herë të dytë. Më datën 24.10.2022 është bërë hapja dhe vlerësimi i ofertave ku përsëri asnjë operator pjesëmarrës nuk ka paraqitur oferta të cilat plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të dokumentave standarde të tenderit. Më datën 30.11.2022, është bërë anulimi. Me nr. REF 52812-12-12-2022 është publikuar më datën 13.12.2022, procedura e prokurimit për herë të tretë.

Më datën 04.01.2023, është bërë hapja dhe vlerësimi i ofertave. Më datën 14.02.2023 është bërë mbyllja dhe vlerësimi i ofertave. Më datën 27.02.2023 është bërë publikimi i njoftimit të fituesit. Më datën 10.03.2023 me nr. 2438 prot., është lidhur kontrata e sipërmarrjes. Në zbatim të nenit 4 (katër) të saj, kontraktuesit i jepet leja për të furnizuar me mall menjëherë me datën e lidhjes së kontratës, sipas afatit (6 muaj) të përcaktuar në dokumentat standarde të tenderit. Për sa më sipër ju bëjmë me dije se pretendimet e ngritura në ankesën e administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 4686 prot., datë 05.05.2023 janë të pabazuara pasi këto veprimtari publike i referohen punimeve të realizuara në zbatim të legjislacionit për Procedurat e Prokurimit Publik, afatit të përcaktuar në Dokumentat Standarde të Tenderimit si dhe në kushtet e përcaktuara në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve kontraktuese. Rasti i referuar si objekt ankimi nuk klasifikohet në kategorinë e veprimtarive publike të ndaluara të sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare apo logjistike të institucioneve vendore gjatë periudhës 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Ecuria e punëve nga ana e bashkisë Gjirokastër bazohet te buxheti i miratuar vjetor dhe te procedura e tenderimit me objekt "Materiale ndërtimi për mirëmbajtje të segmenteve të ndryshme rrugore" e cila është realizuar brenda afateve ligjore. Kjo procedurë nuk është e hapur rishtazi në kohë fushate me qëllim ndikimin në votën e qytetarëve apo me qëllim mosgarantimin e paanshmërisë, mostrajtimin të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor. Fondet e përdorura në këtë procedurë prokurimi nuk janë fonde publike të transferuara rishtazi por fonde sipas planit buxhetor të miratuar të vitit 2022 (VKB Nr.107 datë 24.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022"). Për sa më sipër, bashkangjitur kësaj shkresë po ju vendosim në dispozicion edhe dokumentacionin shoqërues mbi të cilin bazohet arsyetimi tonë lidhur me veprimtarinë objekt shqyrtimi nga ana juaj".

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me nr. 396 ID, vlerësoj se:

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Referuar nenit 3, pika 1.3, shkronja "c" vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit;

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator ka dalë në zbatim të nenit 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore. Vendimi nuk ka për qëllim të ndalojë funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe as të ndalojë procedura normale administrative që kryejnë këto institucione.

Në mënyrë që të konstatohet shkelja e dispozitave të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, përvec kërkesave që parashikon neni 3, pika 1.3, shkronja "c", duhet njëkohësisht të vërtetohet qëllimi zgjedhor që ka pasur institucioni në nxjerrjen e një akti të tillë, si kërkesë e pikës 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Vetëm fakti që një akt nxirret gjatë periudhës zgjedhore apo shtrohen rrugë gjatë periudhës zgjedhore, nuk vërteton "qëllimin zgjedhor", si kërkesë absolutisht të domosdoshme për vërtetimin e shkeljes.

Kështu, në mënyrë që të konstatohet shkelja e këtij nenit duhet të provohohen në mënyrë komulative të gjitha elementët e mëposhtëm :

- 1- Fondet për shtrimin e rrugëve duhet të jenë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.
- 2- Përdorimin ose të vënien në dispozicion të burimeve publike të një organi publik, me qëllim mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

Gjatë hetimit administrimit nuk u arrit të vërtetohej qëllimi zgjedhor në miratimin e një vendimi, i cili rezultoi të jetë bërë në respektim të procedurave të vendosura nga kontratat e lidhura midis institucioneve dhe kontraktorëve. Përsa më sipër, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin nr. 396 ID pasi në këtë rast institucioni publik ka kryer detyrat e tij funksionale dhe nuk jemi para një veprimtarie të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

- Denoncimi nr. 428 ID, më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 199 prot., datë 11.5.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 5052 prot., datë 12.5.2023 dhe zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 13680, i datës 11.5.2023 ku pretendohet se: *“Më datë 7 Maj 2023, Ministri i Arsimit Evis Kushi dhe Kryetari i bashkisë Elbasan, Gledian Llatja organizojnë takim elektorale me mësues. Ministri Kushi, në shkëlqje të hapur të legjislacionit në fuqi, të vendimeve të KQZ-së, kur është ajo vetë e cila ka përgjegjësinë kryesore të sigurojë që arsimi të jetë i depolitizuar, ka kërkuar që mësuesit të votojnë për kandidatin e PS. Duke qenë Ministre e Arsimit ky është një akt kërcënues për çdo mësues që nuk do të votojë për kandidatin e Partisë Socialiste”*.

Më datë 13.5.2023 i është kërkuar informacion palëve të denoncuarra dhe më datë 16.5.2023, jemi informuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve se *“Në përgjigje të denoncimit nr. 5052, datë 12.05.2023, nga z. Ivi Kaso, ku pretendohet se në datën 7 maj 2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit, znj. Evis Kushi dhe kryetari i bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja, organizoi takim elektorale me mësues, ju sqarojmë se, ky aktivitet është zhvilluar jashtë orarit të procesit mësimor dhe orarit të punës së punonjësve arsimorë dhe pjesëmarrja ka qenë e lirë. Në këto kushte nuk jemi para përdorimit të detyruar të “burimeve njerëzore” brenda orarit të punës në kuptim të pikës 2, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Aktiviteti i zhvilluar nuk është veprimtari publike në kuptim të pikës 1, nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Nuk ka asnjë pengesë ligjore për pjesëmarrjen e zj. Kushi në këtë takim, për sa kohë është deputete në Bashkinë Elbasan”*.

Në përfundim të hetimit administrative vlerësoj se, referuar nenit 91, pika 2, të Kodit Zgjedhor *“Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.*

Kjo dispozitë kërkon **“përdorimin e detyruar brenda orarit të punës”** dhe **“për qëllime zgjedhore”**. Në mënyrë që të provohet shkëlqja administrative, nga ana e punonjësve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet, duhet të vërtetohet në mënyrë komulative fakti pjesëmarrja e punonjësve në këtë aktivitet ka qenë e detyruar, brenda orarit të punës dhe ka pasur qëllim zgjedhor. Fakti që ndodhemi para një aktiviteti elektorale, nuk vërteon faktin se pjesëmarrja ka qenë e detyruar. Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në nenin 6, pika 3 e qartëson edhe me tej nenin 91, pikën 2 të Kodit Zgjedhor. Neni parashikon se *“Punonjësit të*

administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje.

Referuar fakteve të denoncuara dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk u arrit të provohej se pjesëmarrja e punonjësve ka qenë e detyruar dhe as që është ushtruar presion ndaj tyre me qëllim përfitimi. Të ndodhur në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi adminsitrativ për denoncimin me nr. 428 ID, pasi të dhënat e denoncuara dhe provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ nuk provuan shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe përdorim të burimeve publike në favor të një kandidati apo subjekti zgjedhor.

- Denoncimi **nr. 425 ID**, më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 195 prot., datë 11.5.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 5056 prot. datë 12.05.2023, kur pretendohet se *"Në bashkinë Mat, kryetari i saj z. Agron Malaj, 4 ditë përpara zgjedhjeve kryen asfaltimin e rrugeve përpara banesës së tij në fshatin Lis, ndërkohë punimet janë selektive, pa respektuar dispozitat ligjore në fuqi për punët civile, duke mos vendosur tabela dhe sinjalistika. E njëjta gjë ka ndodhur dhe në bashkinë Lushnje. Fenomeni i përsëritur me lart shtrim asfalti elektorale, pa standardet e kërkuara, jo vetëm pa sinjalistikë, projekt dhe elemente sigurie që shoqërojnë zbatimin e punëve civile por edhe kryerjen e punimeve gjatë motit me shi, vetëm me qëllim përfundimin e asfaltimit deri në datën e zgjedhjeve lokale të datës 14 Maj 2023".*

Më datë 13.5.2023, i është kërkuar informacion bashkisë Mat dhe më datë 18.5.2023, jemi informuar se *"Investimi me objekt "Rikonstruksion rruga Lis" është miratuar në buxhetin e vitit 2023 me vendimin nr.134, datë 22.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Mat, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1315/1 , datë 04.01. 2023. Më datë 10.01.2023 është shpallur në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), faqja zyrtare e Agjencisë së Prokurimeve Publike, procedura e prokurimit "E Hapur- Punë", prokurim elektronik, me nr. REF-55699-01-09-2023, dhe me objekt "Rikonstruksion rruga Lis", e cila u zhvillua më datë 25.01.2023, ora 10.00. Pas zhvillimit të procedurës së prokurimit sipas rregullave të prokurimit publik, më datë 01.03.2023, u nënshkrua Kontrata e Sipërmarrjes (Për Punë Publike) me nr. 957 prot., datë 01.03.2023, me objekt "Rikonstruksion rruga Lis" me operatorin ekonomik të shpallur fitues. Pretendimet e ankuesit janë të pabaza, pasi sipas kushteve të kontratës së sipërmarrjes, pas miratimit të Lejes së Infrastrukturës nr. 349, datë 31.03.2023, kontraktori më datë 15.04.2023 ka paraqitur njoftimin për fillimin e punimeve nr. AN150420230015 në sistemin elektronik e-leje, dhe në zbatim të pikës 1.2 dhe 1.3. të Kreut II, të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 "Par zbatimin e punimeve të ndërtimit", ka kryer rrethimin e kantierit në përputhje me kushtet urbane dhe ka*

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

vendosur tabelën e identifikimit të punimeve të pozicionuara në sheshin e qendrës së NJA Lis, në krah të djathtë të fillimit të rrugës që po rikonstruktohet (sicc nshihet nga larg në murin e ndërtesës, në videon e dërgua nga ana juaj). Ky projekt përfshin rrugën që nis me koordinata fillimi X-507661.857 Y-4610300.833 dhe koordinata mbarimi X-508808.854 Y-4610551.177 me gjatësi 1297ml dhe sic shihet nga koordinatat ky projekt absolutisht nuk i shërben një individi sipas citimit në ankesën që ju drejtohet, dhe aspak nuk përfshin rrugën për te banesa e z. Malaj. Kjo rrugë lidh fshatrat Lis-Shlli-Gjalish-Vinjoll- Vig- Macukull dhe është rrugë nacionale që lidh bashkinë Dibër me bashkinë Mat nëpërmjet Qafë Murrës. Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendohet nga ankuesi, afati i punimeve sipas kontratës është 7 (shtatë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (datë e cila përkon me njoftimin e fillimit të punimeve), dhe sipas grafikut të punimeve të projektit të zbatimit, punimet e sinjalistikës në rrugë janë parashikuar për t'u kryer gjatë muajit të 6 dhe 7 të afatit të punimeve.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me nr. 425 ID, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Referuar nenit 3, pika 1.3, shkronja "c" vënia **në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme** të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, **për qëllime zgjedhore**, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit.

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator ka dalë në zbatim të nenit 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**. Vendimi nuk ka për qëllim të ndalojë funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe as të ndalojë procedura normale administrative që kryejnë këto institucione.

Në mënyrë që të konstatohet shkelja e dispozitave të vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, përvec kërkesave që parashikon neni 3, pika 1.3, shkronja "c", duhet njëkohësisht të vërtetohet qëllimi zgjedhor që ka pasur institucioni në nxjerrjen e një akti të tillë, si kërkesë e pikës 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor. Vetëm fakti që një akt nxirret gjatë periudhës zgjedhore apo shtrohen rrugë gjatë periudhës zgjedhore, nuk vërteton "qëllimin zgjedhor", si kërkesë absolutisht të domosdoshme për vërtetimin e shkeljes.

Kështu, në mënyrë që të konstatohet shkelja e këtij nenit duhet të provohohen në mënyrë komulative të gjitha elementët e mëposhtëm :

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

- 1- Fondet për shtrimin e rrugëve duhet të jenë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.
- 2- Përdorimin ose të vënien në dispozicion të burimeve publike të një organi publik, me qëllim mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

Gjatë hetimit administrimit nuk u arrit të vërtetohej qëllimi zgjedhor në miratimin e një vendimi, i cili rezultoi të jetë bërë në respektim të procedurave të vendosura nga kontratatat e lidhura midis institucioneve dhe kontraktorëve. Përsa më sipër, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin nr. 425 ID pasi në këtë rast institucioni publik ka kryer detyrat e tij funksionale dhe nuk jemi para një veprimtarie të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
2. Pushimin e hetimit administrativ ndaj:
 - a) Zj. Emiriana Sako, kryetar i bashkisë Durrës;
 - b) Zj. Irena Toshkallari, drejtori i Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Vlorë-Himarë;
 - c) Z. Ermal Dredha, kandidat për kryetar të bashkisë Vlorë;
 - d) Zj. Bukuri Ballhysa, drejtor i shkollës 9- vjeçare “28 Nëntori” Pekisht;
 - e) Z. Leonard Greku, drejtori i shkollës “18 Tetori” Lushnje;
 - f) Z. Rahim Spahiu, kryetar i bashkisë Dibër;
 - g) Z. Adriatik Mema, kryetar i bashkisë Skrapar;
 - h) Z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan;
 - i) Zj. Evis Kushi, Ministër i Arsimit dhe Sportit;
 - j) Z. Ermir Çela, drejtori i Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Elbasan;
 - k) Z. Agron Malaj, kryetar i bashkisë Mat.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 26.6.2023

Nr: 676
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”